



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më .08.2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Shërbimi i prerjes, copëtimit dhe transportit të druve të zjarrit për DPAP”

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – sherbim”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 77220000-8 - Shërbime të trajtimit të lëndëve drusore

VLERA E FONDIT LIMIT - 3,436,065 (tremilion e katerqind e tridhjetë e gjashtëmije e gjashtëdhjetë e pese) lekë pa t.v.sh.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 9;

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit nr.08, date 23.09.2024, të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 9;

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të prokuruar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, referuar nenit 42 pika 3, 43 pika 2/c dhe nenit 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) Në rastin e parvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

b) Në rast se parvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë parvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Një punësim mesatar prej 9 (nëntë) punonjës, për 3 muajt e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të leshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e punonjësve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 4, germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në punët dhe shërbimin që do kryejë operatori ekonomik, në numrin e mjeteve të kërkuara si dhe distancën dhe shpërndarjen gjeografike të njësive administrative,

shkollave dhe kopshteve ku do te behet dorezimi i druve te zjarrit. Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjor në nr.operacionit 92, norma ditore per ngarkim dru zjarri me krahë në automjet është 18 mst/8orë. Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjor në nr. operacionit 103, norma ditore per shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti është 55 mst/8orë. Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjor në nr. operacionit 114 norma ditore per stvim dru zjarri me krahe është 33 mst/8 orë sa me siper eshte llogaritur qe minimalisht 3 punonjes do te duhen per prerjen dhe copetimin e druve, 4 punonjes do te nevojiten per ngarkimin, shkarkimin dhe stivimin e druve te zjarrit si dhe 2 punonjes per transportin (shofere).

2.3.3 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lloji i mjeteve/pajisjeve	Njesia	Sasia
Kamion transporti me kapacitet mbajtes minimumi 7 ton	copë	2
Kamion transporti me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton	cope	1
Motorrsharre	copë	3

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

a) Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;

ose

b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e te perfshije afatin e realizimit te kesaj kontrate.

- *Për mjetet ne pronesi ose te marra me qera si me lart që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), si dhe lejen e transportit për vete ose të tretë per atomjetet qe pajisen me leje transporti sipas legjislacionit ne fuqi.*

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të

mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri 2.3.3 është vendosur referuar nenit 41 pika 4, germa ç) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në baze të pikës 4, të nenit 77 të ligjit, me anë të këtij kriteri kërkohej që OE të deshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën. Numri i mjeteve të kërkuar është referuar natyrës së shërbimit që do të realizohet si dhe në baze të grafikut të shpërndarjes të lëndës drusore në pikat e përcaktuara nga AK. Motosharrat janë kërkuar për të kryer prerjen dhe copetimin e druve të zjarrit. Numri i kërkuar është në propozicion me sasinë e druve sipas preventivit.

Kamionet janë kërkuar për transportin e druve të zjarrit në destinacionin e përcaktuar nga AK. Peshat e druve të zjarrit për 1 ton është 2.32 mst. Për të realizuar shërbimin e plotë të transportit të lëndës drusore nga fusha e bashkisë deri në ambjentin e OE, dhe me pas shpërndarja deri në destinacion, nevojiten minimalisht 2 kamione me tonazh minimumi 7 ton, një kamion me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton. Numri është në përputhje me sasinë, distancën dhe shpërndarjen gjeografike të njësive administrative, shkollave dhe kopshteve. 2 kamione me tonazh minimumi 7 ton janë kërkuar për të bërë kryesisht transportin e lëndës drusore nga fusha e bashkisë deri në ambjentin e OE, dhe me pas shpërndarja në njësitet administrative (gjithsej 12), ndërsa një kamion me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton është kërkuar për të bërë shpërndarjen në shkollat dhe kopshtet brenda qytetit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi apo me qira një ambjent me sipërfaqe minimalisht 400 m², i cili do të shërbejë për magazinimin e druve.

Për të vertetuar sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e qirase (bashkë me certifikatën e pronësisë), e cila duhet të jetë notoriale dhe të ketë specifikuar destinacionin e përdorimit sipas objektit të tenderit për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponueshmërinë dhe adresën e saktë të ambjentit. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambjentit.**

Argumentimi: Kriteri 2.3.4 është vendosur referuar nenit 41 pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në baze të pikës 4, të nenit 77 të ligjit, pasi është e nevojshme për të realizuar shërbimin e kërkuar si depozitim të lëndës drusore në përputhje me kushtet teknike si dhe stivimin e tyre pas prerjes dhe copetimit. Sipërfaqja e kërkuar bazohet në sasinë e druve të zjarrit. Konkretisht janë 2422 mst dru zjarri, të cilat do të depozitohen në ambjentet e operatorit ekonomik, ku do të bëhet me pas prerja, copetimi, stivimi dhe transporti. Sipërfaqja prej 400 m² është llogaritur duke pasur parasysh që gati gjysma e kësaj sasive do të bëhet gati dhe shpërndahet brenda datës 15 nëntor dhe duke pasur parasysh depozitim të lëndës drusore në përputhje me kushtet teknike, hapësirën që do të duhet për prerjen dhe copetimin e tyre, stivimin e tyre pas prerjes dhe copetimit në një lartësi jo më shumë se 2-3 m për arsye sigurie, si dhe levizjen e mjeteve për ngarkim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT